



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo- Republic of Kosova  
Qeveria - Vlada - Government

Komuna Obiliq - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d), nenit 12.1, nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c), nenit 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), neni 27 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 44.1 dhe 47.3, nenit 72, pika 1. e Statutit të Komunës së Obiliqit, nr.I-34 i dt.25.04.2016, si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, nenit 34 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi Komunal pas shqyrtimit të kërkesës nr.-V-1177, të dt.22.09.2022, në mbledhjen e mbajtur me dt.27.09.2022 mori këtë:

## VENDIM

**Për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Obiliq**

### Neni 1

Shpallja e interesit të përgjithshëm publik bëhet për shpronësimin e Njësive Kadastrale si në vijim :

- **P-72614055-01279-5**, Lloji i Njesisë: Parcel; Zona:Rurale; Vendi i quajtur: Novi Obiliq; Lloji i shfrytëzimit të parcelës: Tokë Ndërtimore; Shfrytëzimi aktual i parcelës: Shtëpi - Ndërtesë; me sipërfaqe prej 909 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1; zona kadastrale: Obiliq e cila evidentohet në emër të **P.SH. KNI RAMIZ SADIKU dhe ;**

- **P-72614055-01279-12**, Lloji i Njesisë: Parcelë; Zona:Rurale; Vendi i quajtur: Novi Obiliq; Lloji i shfrytëzimit të parcelës: Tokë Ndërtimore; Shfrytëzimi actual i parcelës: Shtëpi - Ndërtesë; me sipërfaqe prej 1400 m<sup>2</sup>; Pjesa e Pronës 1/1; zona kadastrale: Obiliq e cila evidentohet në emër të **P.SH. KN JABLLANICA .**

### Neni 2

Qëllimi i këtij Vendimi për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm Publik të ngastrave kadastrale të cekura si në nenin 1 të këtij Vendimi është Shpronësimi i këtyre Ngastrave Kadastrale për nevoja të Komunës së Obiliqit , në të cilat planifikohet realizimin e projekteve të ndryshme .

Vlera e kompensimit për pronën që do të shpronësohet do të caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-

205 të datës 28 tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015 për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përlogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që do të shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin .

Neni 3

Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria e Planifikimit Urban, Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 do t'i drejtohet Qeverisë së Republikës së Kosovës ( Departamentit të Shpronësimit) për fillimin e procedurës së shpronësimit.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Planifikimit Urban, Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë si dhe Drejtoria e Financave .

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

Këtij Vendimi ia bashkangjesim:

- Çerifikatën Pronësore dhe Kopjen e Planit .

T'i dërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesueses
- Anëtarëve të KK
- MAPL
- DPUKP
- DEFZH
- Arkivit



**Kryesuesja e Kuvendit komunal**

**Vlora Mjekiqi Kabashi**